Ndërmarrja Publike Lokale
KASTRIOTI
Adresa: Rr. "Llapi" pn – Obiliq | Tel: +383 46 666 607
Email: nplkastrioti@gmail.com | Web: www.nplkastrioti.com

Data: 25.11.26
Nr. Prot: I-2948/26

Në mbështetje të Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datë 01.12.2010, lidhur me nenin 4 dhe 7 nën par. 1.8 të Udhëzimit administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, dhe i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 20 par. 1 i Rregullores Nr. I-547/26 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, i miratuar nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Kastrioti" Sh.A., lidhur me Konkursin Publik Nr. **I-2778/26** të datës **10.11.2026, Kryeshefi Ekzekutiv – Flakron Mjekiqi** me datë **25.11.2026** nxjerr:

VENDIM
(Për shtyrjen e konkursit publik nr. I-2778/26 të datës 10.11.2026)

1. **SHTYHET** Konkursi Publik me nr. **I-2778/26** të datës **10.11.2026,** për plotësimin e katër (4) vendeve të lira për pozitën të ndryshme të punës.
2. Kriteret dhe kushtet e cekura në shpalljen e konkursit mbesin të njëjta.
3. Kandidatët të cilët kanë aplikuar nuk është e nevojshme të aplikojnë përsëri.
4. Kalendari i përafërt i konkursit, riprogramohet në pajtueshmëri me datat e shtyrjes së këtij konkursi.
5. Ky konkurs pas shtyrjes duhet të jetë i hapur deri me datë **18.12.2026,** dhe ky vendim duhet të publikohet në tabelën e shpalljes në N.P.L "Kastrioti" Sh.A. në Obiliq.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv.

Arsyetim

Me datë 10.11.2026 është shpallur konkursi publik për plotësimin e katër (4) vendeve të lira për pozita të ndryshme të punës, me afat fillestar të aplikimit nga data 10.11.2026 deri më 24.11.2026. Megjithatë, në mbështetje të nenit 81, par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Kur afati përcaktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja nga e cila fillon të ecë afati"*, llogaritja e afatit ligjor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh ka filluar të ecë nga data 11.11.2026, ndërsa data e fundit e aplikimit është 25.11.2026 ora 16:00.

Gjatë kësaj periudhe kohore, për pozitën e lartcekur të punës nuk ka aplikuar asnjë kandidat. Duke marrë parasysh rëndësinë e veçantë që ka plotësimi i këtyre pozitave për mbarëvajtjen e proceseve të punës në ndërmarrje, vlerësohet e domosdoshme shtyrja e afatit të këtij konkursi publik, me qëllim të mundësimit të aplikimit dhe sigurimit të interesimit nga kandidatët potencialë. Në këtë drejtim, Bordi i Drejtorëve, përmes Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, ia ka njohur Kryeshefit Ekzekutiv kompetencën diskrecionale për shtyrjen e afatit të konkursit publik, konkretisht në nenin 20, par. 1, ku përcaktohet se: *"Konkursi publik shpallet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe mbetet i hapur së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e publikimit, i cili afat mund të shtyhet në bazë të një vendimi të veçantë të Kryeshefit Ekzekutiv."*

Kriteret dhe kushtet e konkursit mbeten të njëjta, kandidatët të cilët kanë aplikuar në këtë konkurs nuk është e nevojshme të aplikojnë përsëri. Ky konkurs pas shtyrjes duhet të jetë i hapur deri me datë 18.12.2026, dhe ky vendim duhet të publikohet në tabelën e shpalljes në N.P.L "Kastrioti" Sh.A. në Obiliq. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv.

E drejta në mjete juridike: *Kundër këtij vendimi të pëkanqurit, kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës kompetente brenda afatit tridhjetë (30) ditë me padi nga dita e pranimit të vendimit, nëse konsideron se i është shkelur apo cenuar ndonjë e drejtë, mirëpo që nuk shtynë ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi i dërgohet:

- *Zyrës së Sekretarit;*
- *Zyrës së Arkivës;*

Flakron Mjekiqi

Kryeshef Ekzekutiv në N.P.L "Kastrioti" Sh.A.